# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-418464**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Sekretari i Thesarit: SHBA do të sanksionojë këdo që bën biznes me Gardën Revolucionare të Iranit – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/sekretari-i-thesarit-shba-do-te-sanksionoje-kedo-qe-ben-biznes-me-garden-revolucionare-te-iranit/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 23:35:33 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 1 shtator 2026, 15:31:58 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `4d77f11c4ee30ebf26db1b8da6e93e342acf07e7585e836df824fa2f1fc4af3a` |
| TEKSTI | `6ae485b09643f4e3dc1c77f78ed881fb7bad543c18e12af690d2800afbc9b2ca` |
| PAMJA | `8d3b7ff2394dfc0b24d0b08778a34bac5329eee5bf2fa3d24ffa173f3a96e7d0` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `0c19469abe65992e257bc717a5008ab6c5180771231d4645c8e0259a8a8548f9` |
| E MËPARSHMJA | `8acb175ecc5adf345eb99b4d4f64b5ab103fd12992ed082bbaa8e0675287d7ef` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/0c19469abe65992e257bc717a5008ab6c5180771231d4645c8e0259a8a8548f9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

gjatë takimeve të ministrave të financave dhe guvernatorëve të bankave qendrore të G20-ës se Shtetet e Bashkuara do të shpallin sanksione të reja ndaj "kujtdo që bën biznes me IRGC-në" (Gardën Revolucionare Islamike të Iranit), ndërsa janë duke gjurmuar aktivet e kësaj force në mbarë botën.

Në deklaratat e tij në anën e takimit të G20-ës në Asheville, Bessent vlerësoi se Irani ndodhet tani "në një gjendje ekstreme distrese ushtarake".

Ai pretendoi se SHBA-ja "shkatërroi" marinën e Iranit, aviacionin e saj dhe inventarin e dronëve, si dhe "*85 ose 90 për qind të fabrikave" që mund të ndërtonin dronë të rinj. Sipas tij, bllokada detare është "shumë e fuqishme" dhe Washingtoni do të vazhdojë të ushtrojë presion maksimal."Ne do ta asfiksojmë ekonomikisht këtë regjim*", theksoi Bessent, duke shtuar se SHBA-ja ka "tolerancë zero".

Ai bëri të ditur se autoritetet amerikane janë duke gjurmuar aktivet e IRGC-së dhe se sanksionet e reja mund të prekin edhe kompani që merren me qira të avionëve apo çdo entitet tjetër që bashkëpunon me Gardën Revolucionare.Këto deklarata vijnë në kuadër të fushatës "Operation Economic Outcast" (Operacioni Ekonomik i Përjashtimit), e nisur së fundmi nga Thesari amerikan.

Qëllimi i kësaj fushate është të presë çdo burim të ardhurash që financon regjimin iranian dhe IRGC-në, duke zgjeruar sanksionet dytësore ndaj bankave, kompanive të transportit, aseteve digjitale, arit, aviacionit dhe sektorëve të tjerë. Bessent theksoi se SHBA-ja ka hartuar hartën e plotë të rrjeteve që Irani ka përdorur për të shmangur sanksionet e mëparshme dhe për të eksportuar naftë.

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

dhe për të eksportuar naftë.

Ai paralajmëroi se çdo vend apo kompani që vazhdon të lehtësojë veprimtaritë e Iranit do të përballet me pasoja të rënda, duke përfshirë përjashtimin nga sistemi financiar i bazuar në dollarin amerikan.

Në kontekstin e konfliktit të zgjatur me Iranin, zyrtarët amerikanë kanë pretendar më herët se goditjet ushtarake kanë shkatërruar pjesën më të madhe të kapaciteteve ushtarake iraniane, duke përfshirë flotën detare, aviacionin dhe bazën industriale për prodhimin e dronëve e raketave.

Bessent e lidhi këtë situatë ushtarake me presionin ekonomik, duke thënë se bllokada dhe sanksionet e reja po e vendosin regjimin në një pozitë të vështirë.

Takimet e G20-ës po zhvillohen në një kohë të tensionuar për ekonominë globale, me ndikime nga konflikti në Lindjen e Mesme, çmimet e larta të energjisë dhe tensionet tregtare. Bessent tha se ka pasur “diskutime shumë të mira” me aleatët dhe se SHBA-ja pret mbështetje për shkëputjen e lidhjeve ekonomike me Teheranin.

#ScottBessent #SekretariiThesarittëShtetevetëBashkuara #VizionPlus

**Redaksia Web**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh




BOTA

**Sulm me dron ndaj një anijeje ruse në Detin...**

Xhuljana Zhuleku · 30 minuta më parë



BOTA

**Trump i kërkon Zelenskyt të...**

Xhuljana Zhuleku · 1 orë më parë



BOTA

**Tragjedi! Përmbyset anija me pasagjerë,...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 23:17



© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.